



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 519, datë 05.10.2023

PËR

**TRANSFERIMIN E GJYQTARIT Z. {...} NË PROCEDURËN E
LËVIZJES PARALELE NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM ELBASAN**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4, të nenit 135, pikën 1, të nenit 147, në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative, në shkronjën “ç”, të nenit 85 e 86 dhe nenet 97 e 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 7,10 dhe 12, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 248, datë 24.05.2023, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve,

VENDOSI:

1. Transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
2. Gjyqtari z. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, si edhe gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ai ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, të caktuara me vendim të Këshillit.
3. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 16.10.2023.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR